



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 dhe nenit 67.1 paragrafi (a) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës Zgjedhore Nr.18/2016 për Emërimin, Përbërjen dhe Funksonimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 13.10.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Rekomandimit të Sekretariatit të KQZ-së për Emërimin e U.D Zyrtares të Lartë Komunal të Zgjedhjeve si Kryesues i KKZ-së në Komunën e Dragashit për Zgjedhjet Lokale 2021

- I. Miratohet rekomandimi i Sekretariatit të KQZ-së për emërimin e U.D Zyrtares të Lartë Komunal të Zgjedhjeve si Kryesues i KKZ-së në Komunën e Dragashit për Zgjedhjet Lokale 2021.
- II. Z. Haxhi Berisha, emërohet përkohësisht u.d Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve, në Komunën e Dragashit, për zgjedhjet lokale 2021, për periudhën nga data 13.10.2021, deri 30 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.10.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Data / Datum	13.10.2021
Për / Za	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
Nga / Od	Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Terren
Përmes/Preko	Këshillit për Operacione Zgjedhore Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së
Kopje / Kopija	Arkivës / KKZ-Dragash
Lënda / Predmet	Rekomandim për emërimin e U.D Zyrtarit të Lartë Komunal të Zgjedhjeve si Kryesues i KKZ-së për Zgjedhjet Lokale 2021 në Komunën e Dragashit

Të nderuar

Duke u bazuar në vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës, Nr.protokolli 44-2021 të datës 02.06.2021 për shpalljen e Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, të pranuar në KQZ-së me Nr.protokolli 1645-2021, datë 15.06.2019, vendimit të KQZ-së Nr.1661-2021 të datë 18.06.2021 për miratimin e Planit Operacional për Zgjedhjet Lokale 2021 në Republikën e Kosovës si dhe në bazë të obligimeve kushtetuese që ka KQZ, respektivisht Sekretariati i KQZ-së, për funksionalizimin, menaxhimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në mënyrë profesionale, efikase, të pavarur dhe mirë të administruar. Departamenti i Koordinimit në Terren, si njësi organizative në kuadër të Sekretariatit të KQZ-së, kërkon nga Këshilli për Operacione Zgjedhore dhe KQZ të miraton kërkesën tonë **emergjente** me arsyeshmërinë e saj.

Pra, kërkojmë nga ju, që të miratoni kërkesën për emërimin e ish Zyrtarit të Lartë Komunal të Zgjedhjeve në komunën e Dragashit si u.d Kryesues i KKZ-së në Komunën e Dragashit, që nevojitet në këtë periudhë emergjente në cilën gjendemi ne si institucion për organizimin dhe administrimin e Zgjedhjeve Lokale të datës 17 tetor 2021, ish zyrtari Haxhi Berisha, i cili tanimë kanë dalur në pension është person që ka punuar që prej themelimit të institucionit, pra me njohuri të shkëlqyeshme për proceset zgjedhore, i cili ka qenë i suksesshëm, në menaxhimin dhe kryesimin e zyrës së KKZ-së në Dragash, që të njëjtin e rekomandojmë për KQZ-në të emëron Kryesues të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Dragashit.

Arsyetim

Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve (ZLKZ) z.Fesal Xhabali, me datë 09.10.2021 ka pësuar aksident të rëndë komunikacioni përgjatë rrugës Dragash-Prizren, dhe se aktualisht, gjendja e tij shëndetësore është tejet e rëndë, në kliniken intensive në QKUK, kështu që ZLKZ z.Fesal Xhabali akoma është në gjendje kome.

Sekretariati i KQZ-së, tashmë është në fazën finale të përgatitjeve për zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021, e që urgjenca të kemi zyrtar në pozitën në fjalë është më se urgjente, pasi që kemi

në dispozicion vetëm edhe tre (3) ditë deri në ditën e zgjedhjeve, e që mungesa e ZLKZ.Kryesuesit të KKZ-së në këtë komunë mund të shkaktojë pasoja të pariparueshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Lidhur me këto që u theksuan më lartë, kërkojmë që kërkesa e DKT-së të aprovohet si e tillë, dhe që në funksion të zbatimit të obligimeve kushtetuese e ligjore të KQZ-së për Zgjedhjet e Lokale 2021, personi me përvojë të gjatë zgjedhore i rekomanduar (z.Haxhi Berisha) të emërohet përkohësisht Kryesues i KKZ-së, deri në 30 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare. Pra me qëllim të kryerjes të të gjitha obligimeve dhe detyrimeve ligjore sipas detyrave të ZLKZ-së në KKZ, dhe përfundimit të të gjitha pagesave të KVV-ve dhe stafit teknik të QV-ve. E në rast se, para kësaj periudhe rikthehet ZLKZ Fesal Xhabali, pastaj z.Haxhi Berisha të ri pozicionohet në pozitën e Anëtarit të KKZ-se si KKZ.

Me respekt,